



VENDIM

Nr. 137, Datë 15.08.2016

**MBI KËRKESËN E OST SH.A. LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE
NË RRJETIN E TRANSMETIMIT PËR PERIUdhËN E MBETUR TË
VITIT 2016**

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 dhe 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën e mbetur të vitit 2016,

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me anë të shkresës Nr. 4207 Prot., datë 17.07.2016, i është drejtuar ERE-s, lidhur me trajtimin e mbulimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit, për periudhën e mbetur të vitit 2016.
- MEI me shkresën Nr. 4514/1 Prot., datë 03.08.2016, ka dërguar në ERE qëndrimin e saj lidhur me kërkesën e OST sh.a për lënien të pandryshuar edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 të çmimit të energjisë elektrike që OST sh.a i paguan KESH sh.a, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.
- ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën e mbetur të vitit 2016, duke filluar nga 01.08.2016 – 31.12.2016, OST sh.a të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e “Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”, miratuar me Vendimin Nr. 78, date 07.06.2016 të Bordit të ERE.
2. Pika 3 e vendimit nr 102 date 23.06.2016 te Bordit te ERE “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat” shfuqizohet.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a dhe KESH sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.